

MODULI I ALARM-IT MICRA NGA SATEL

January 2021 | CSP




Vilë verore, garazh, njësi lëvizëse e shitjes së ushqimeve... pavarësisht specifikës së tyre, një instalim i bazuar në modulën e alarmit MICRA do t'u sigurojë atyre mbrojtjen e duhur. Dhe jo vetëm kundër vjedhjeve!

Mbi bazën e modulit të alarmit MICRA, ju mund të ndërtoni një sistem plotësisht wireless ose me kablllo, ose një instalim hibrid që ndërthur përparësitë e të dy teknologjive. Falë këtij fakti, ju mund ta përshtatni sistemin me karakteristikat specifike të ndërtesës dhe me nevojat tuaja. Moduli ka një furnizim të integruar të energjisë me mundësinë e lidhjes së një baterie - një zgjidhje e tillë siguron funksionim të qëndrueshëm të sistemit dhe mbrojtje të pandërprerë edhe gjatë ndërprerjes së energjisë. Nga ana tjetër, kur nuk ka qasje në rrjetin AC (p.sh. në një karvan ose kamion ushqimi), pajisja mund të furnizohet me bateri 12 V.

Gjithcka nën kontroll!

Raste të përdorimit të sistemit të Alarmit Micra:

- Dëshironi të siguronit një ndërtesë ose objekt të vogël, p.sh. një kioskë, kamion ushqimi, shtëpi verore, karvan ose garazh.
- Kërkoni një zgjidhje të përkohshme që mund ta instaloni me lehtësi dhe shpejt, dhe gjithashtu ta hiqni pas një kohe, p.sh. për të siguruar ndërtesën gjatë ndërtimit, përfshirë materialet e ndërtimit.
- Keni nevojë për një sistem të vogël, fleksibël dhe të përballueshëm që do t'ju ofrojë një mbrojtje të menjëhershme dhe efektive.
- Dëshironi një sistem të thjeshtë alarmi për të mbrojtur objektin jo vetëm nga vjedhjet, por edhe për të raportuar shenjat e para të zjarrit ose përmbytjes.



“

*CSP - Official
Distributor of
SATEL
Technologies*